



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Nr. 12-06-12931 më 06.03.2015

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Nexhat Demaku

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 27.02.2015

1. Vendim për mbeshtetje më mjete financiare "Handikosit,, - Drenas
2. Vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale më pronën e paluajtshme private për nevojat e zgjerimit e varrezave të fshatit Korretic e ulët – Komuna e Drenasit
3. Vendim për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale më pronën e paluajtshme private për nevojat e ndërtimit të rezervuarit të ujit të pijes në Zabel të epërme – Komuna e Drenasit
4. Vendim për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale më pronën e paluajtshme private për nevojat e ndërtimit të Ambulances familjare në fshatin Negroc- Komuna e Drenasit
5. Vendimi për ndryshimin e nenit 1 të Vendimit 01 Nr.421 – 8861 të datës 31.12.2008 për dhënien me Koncesion të tokës ndërtimore komunale BIK- dega- Drenas
6. Vendimet për subvencionimin e klubeve sportive
7. Vendim për anulimin e vendimit të stacionit të autobusëve
8. Vendim për Formimi i komisionit për mbikqyrje të projekteve në teritorin e Komunës së Drenasit
9. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake
10. Vendim për aprovimin e rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2014



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)

Kuvendi i Komunës
Nr. 400-12457 dt 5.03 2015



Në baza të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr 03/L-040 për vetqeverisje Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve e miratuar më dt.29/06/2011 nga Kuvendi Komunal Drenas 01 Nr.031-6566, dt.30/06/2011 pastaj Buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas për vitin 2015. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.27.02.2015 mori këtë:

VENDIM

I. Aprovohet Vendimi për mbështetja me mjete financiare, Qendrës për Rehabilitim e Bazuar në Bashkësi "HANDIKOS"- dega në Drenas për realizimin e Projektit "Përkrahja e shërbimeve Rehabilituese në bashkësi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar që ofrohen nga Qendra Handikos në Drenas".

II. Për realizimin e Projektit, (Qendrës së RBB-së "Handikosit"-dega në Drenas) të përkrahet financiarisht në shumën prej 5.000€uro.

III. Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti të lejohen nga subvencionet dhe transferet. kodi ekonomik 21/73010/200.

IV. Mjetet financiare barten në konton e Qendrës e R.B.B- së "Handikos" nr. 1700200000170004 në NLB - dega në Drenas.

V. Qendra për Rehabilitim e Bazuar në Bashkësi „Handikos“-dega në Drenas pas realizimit të projektit "Përkrahja e shërbimeve Rehabilituese në bashkësi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar, drejtë integritetit të tyre në shoqëri" është e obliguar që me raport tekstual dhe financiar ta njoftojë DSHMS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 353-12312 dt. 04.03 2015



Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt. 22 Nëntor 2012, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur më datë: 27.02.2015 aprovoj këtë:

V E N D I M

Për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e zgjerimit e varrezave të fshatit Korroticë e Ultë, Komuna e Drenasit

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Drenasit Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevojat e zgjerimit e varrezave të fshatit Korroticë e Ultë, Komuna e Drenasit “.

II.

APROVOHET këmbimi i një pjese të ngastrës kadastrale: P-127-0, zona kadastrale në Korrotica e Ultë, vendi i quajtur “Korrotica e Ultë” në sipërfaqe prej 0,035,79 ha, sipas Aktvendimit të Komosacionit nr.461-46 dt. 02.02.1987 në pronësi të Adem Ahmet Ahmeti, trashëgimtar (Muhamet Adem Ahmeti) nga Korrotica e Ultë e cila paluajtshmeri do të 5 shfrytëzohet për zgjerimin e varrezave të fshatit Korroticë të Ultë, Komuna e Drenasit. Prona private e cekur më lartë do të këmbëhet me pronën komunale në zonën kadastrale Korroticë të Ultë në pjesën e parcelës nr.720/2 me kulturë kullosë në vendin e quajtur “Bojanishte” në sipërfaqe prej S=----- ha, në pronësi të Komunës së Drenasit, në vlerë që do të caktohet nga zyra për vlerësimin e paluajtshmerive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

III.

Obligohet Kryetari i Komunës, që brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Drenasit të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin e pronës privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrave Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe propozimit të DSHMS dhe pas lidhjes së kontratës me Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronës së këmbyer në Regjistrat Kadastral.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e K Drenas, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Drenas.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 353-12306 dt 04.03. 2015



Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt. 22 Nëntor 2012, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur më datë: 27.02.2015 aprovoj këtë:

V E N D I M

Për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e ndërtimit të rezervuarit të ujit të pijes në Zabel të Epërm, Komuna e Drenasit

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Drenasit Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevojat e ndërtimit të rezervuarit të ujit të pijes në Zabel të Epërm, Komuna e Drenasit.

II.

APROVOHET këmbimi i një pjese të ngastrës kadastrale: P-366-2, zona kadastrale në Zabel i Epërm, vendi i quajtur "Quka" në sipërfaqe prej 0,08,29 ha, e në pronësi të Ali Imeri nga Zabeli i Epërm e cila sipërfaqe do të përdoret për ndërtimin e rezervuarit të ujit të pijes në këtë lokacion, Komuna e Drenasit.

Prona private e cekur më lartë do të këmbëhet me pronën komunale në zonën kadastrale Komoran në pjesën e parcelës kad. 4/___ në vendin e quajtur "Fusha e Gjerë" me kulturë kullës kl.2 tokës ndërtimore në sipërfaqe prej S=----- ha në pronësi të Komunës së Drenasit që do të caktohet nga zyra për vlerësimin e paluajtshmerive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave

III.

Obligohet Kryetari i Komunës, që brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Drenasit të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin e pronës privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrave Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe propozimit të DSHMS dhe pas lidhjes së kontratës mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronës së këmbyer në Regjistrat Kadastral.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e K Drenas, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Drenas.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 353-12304 dt 04.03. 2015



Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt. 22 Nëntor 2012, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur më datë: 27.02.2015 aprovoj këtë:

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e ndërtimit të Ambulancës familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Drenasit Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevojat e ndërtimit të Ambulancës familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit "

II.

APROVOHET këmbimi i një pjese të ngastrës kadastrale: P-962-0, zona kadastrale në Negroc, vendi I quajtur "KRG-TE SHKOLLA" në sipërfaqe prej 0,05,00 ha, e në pronësi të Nuredin Sali Krasniqi nga Negroc i cila sipërfaqe do të përdoret për ndërtimin e Ambulancës Familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit.

Prona private e cekur më lartë do të këmbëhet me pronën komunale në zonën kadastrale Komoran në pjesën e parcelës kad. 4/___ në vendin e quajtur "Fusha e gjerë" me kulturë kullosë kl.2 tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=----- ha që do të caktohet nga zyra për vlerësimin e paluajtshmerive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

III.

Obligohet Kryetari i Komunës, që brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Drenasit të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin e pronës privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcelimin e ngastrave Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe propozimit të DSHMS dhe pas lidhjes së kontratës mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bëjë regjistrimin e pronës së këmbyer në Regjistrat Kadastral.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e K Drenas, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Drenas.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 421-12467 dt 05.03 2015

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 273 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës (Gllogoc) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë : 27.02.2015 aprovon këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e nenit 1 të Vendimit 01 Nr. 421-8861 të datës 31.12.2008 për Dhënie me Koncesion të tokës ndërtimore komunale BIK-ut,-Dega në Gllogoc .

- I. Ndryshohet nenit 1 i Vendimin 01 nr.421-8861 të datës 31.12.2008 mbi dhenjen me koncesion të tokës ndërtimore komunale nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.743/1,në vendin e quajtur "Arat e Ibrit"me kulturë tokë ndërtimore,sipas fletës poseduese nr.87,Zona Kadastrale Gllogoc,në sipërfaqe prej 0.13,82ha,në afat të caktuar prej 34(tridhjetekatër)vitesh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij Vendimi Bashkësisë Islame të Kosovës-dega në Gllogoc. Pjesët tjera të Vendimit 01 Nr.421-8861 të datës 31.12.2008,mbetën të pandryshuara
- II. Obligohet Drejtorati për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronësi-Zyra kadastrale pas hyrjes në fuqi të këtij PropozimVendimi të benë vazhdimin e REGJISTRIMIT të kësaj palujtshmërie në RDPP sipas pikës një(1) të këtij PropozimVendimi .
- III. Obligohet Kryetari i Komunës me Koncesionarin ta nënshkruan Anekskontratën mbi dhënie e tokës ndërtimore komunale me koncesion në kuptim të këtij Vendimi.
- IV. Me këtë Vendim do të njoftohen Autoriteti Kontraktues,Koncesionari dhe një mbete për evidencë.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gllogocit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gllogocit.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e portokolit të MAPL dhe publikim në uebfaqën e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-12475 dt 05.02 2015

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c. të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2015 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 27.02.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovet kërkesa për mbështetje financiare për projektin e K.F., „Feronikeli” lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranëveror- vjeshtor 2015, anëtar i supërligës së Kosovës.

Neni 2.

Projekti i K.F., „Feronikeli” përkrahet me shumën prej 30.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2015.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve. kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.


Mjetet financiare barten në konton e KF, „Feronikeli”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF „Feronikeli” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DRKS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400 - 12471 dt 05.03. 2015

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b dhe c , të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2015 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 27.02.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovet kërkesa për mbështetje financiare për projektin e KH „Drenica“ lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranëveror- vjeshtor 2015 , anëtare e supërligës së Kosovës.

Neni 2.

Projekti i KH „Drenica ” përkrahet me shumën prej 13.500€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2015.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KH „Drenica “. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij vendimi të përcjellë implementimin e projektit , duke kërkuar nga KH ”Drenica “ që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës. Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-12460 dt 05.05. 2015

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c. të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b, dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2015 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 27.02.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovohet kërkesa për mbeshtetje financiare për projektin e KV „Drenasi” lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranëveror- vjeshtor 2015 , anëtar i supërligës së Kosovës.

Neni 2.

Projekti i KV „Drenasi ” përkrahet me shumën prej 5.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2015.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KV „Drenasi ”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij vendimi të përcjellë implementimin e projektit , duke kërkuar nga KV ”Drenasi ” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DRKS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Baza



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-12464 dt 05.03.2015

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2015 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 27.02.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovohet kërkesa për mbeshtetje financiare për projektin e KV „Gryka ” lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranëveror- vjeshtor 2015 , anëtare e ligës së parë të Kosovës.

Neni 2.

Projekti i KV „Gryka ” përkrahet me shumën prej 3.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2015.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.


Mjetet financiare barten në konton e KV „Gryka ”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij vendimi të përcjellë implementimin e projektit , duke kërkuar nga KV ”Gryka “ që të bëjë raport tekstual dhe financiare në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendit i Komunës



12 Nr. 06-12938 dt 06.03 2015

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 pika (e) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale
nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunes se
Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt.29.02.2015 miratoi këtë :

VENDIM

**PËR FORMIMIN E KOMISONIT PËR MBIQYRJE TE PROJEKTEVE NË TERITORIN E
KOMUNËS SË DRENASIT**

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni për mbikqyrje të projekteve në teritorin e
Komunës së Drenasit ,në këtë përbërje:

1. Haka Tahiraj
2. Xhavit Drenori
3. Sabrije Kukaj
4. Rifat Bilalli
5. Astrit Bucolli

Neni 2

Komisioni ka për qëllim që në bashkpunim me Kryetar të fshatrave të mbikqyrë
projektet dhe në rast të ndonje verejtje të njoftoj organet përgjegjëse profesionale të
Komunës se Drenasit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës,dhe vlerësimit të
ligjeshmerisë nga Pushteti Qendror.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 344-12477 dt 05.03 2015

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kërkesës së N.T.SH. "Vëllezërit Thaqi" me seli në Llapushnik, Komuna e Glogocit, 01 Nr. 344-2535 të datës 19.01.2015 mbi ndërprerjen e Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat "Dhënia me koncesion e së drejtës për Stacionin e Autobusëve dhe Objekteve përcjellëse në Glogoc" 01 Nr.344-123 të datës 04.01.2013 dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogoc) Kuvendit i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datë: 27.02.2015 aprovoj këtë :

V E N D I M


Për Anulimin e Vendimit Nr.344-8473 të dates 11.06.2012 për Dhënien me Koncesion Stacionin e Autobusëve me Objekte Përcjellëse në Glogoc .

- I. Anulohet Vendimin nr.344-8473 të dt.11.06.2012 mbi dhenjen me koncesion Stacionin e autobusëve në Glogoc, me objektet përcjellëse Operatorit ekonomik N.T.SH. "Vellëzerit Thaqi" me seli në Llapushnik, Komuna e Glogocit sipas Ligjit nr.03/L-090 për Partneritet Publiko Privat dhe Koncesion dhe Procedurat e dhënies së tyre për arsye së Kontraktori në mungesë të mjeteve financiare nuk është në gjendje të realizoj dinamikën e paraparë të planit investues të zotimeve të marra sipas nenit 5.1 paragrafi (b) të Marrëveshjes për Partneritet publiko Privat 01 Nr.344-123 të datës 04.01.2013 .
- II. Meqe kontraktori nuk mund të realizon obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja sipas dinamikës në kuptim të nenit 14.8 të Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat 01 Nr.344-123 të dates 04.01.2013 të gjitha objektet e ndërtuara nga kontraktori sipas kësaj Marrëveshje kalojnë në pronësi të autoritetit kontraktues përkatësisht të Komunës.
- III. Obligohet Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi-Zyra kadastrale që pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të benë **ÇREGJISTRIMIN** e palujtshmërisë, të objekteve që l është dhënë në shfrytëzim dhe të ndërtuara sipas Marrëveshje për Partneritet Publiko Privat kontraktorit duke regjistruar të njëjtat në emër të autoritetit kontraktues-Komunës.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës të formoj komisionin për pranim-dorëzim të palujtshmërisë dhe objekteve që janë objekt i kësaj Marrëveshje në bashkëpunim me kontraktorin pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi duke hartuar procesverbalin mbi pranim dorëzim të aseteve që do t'i dozohen autoritetit Kontraktues.

- V. Me këtë Vendim do të njoftohen Autoriteti Kontraktues, Kontraktori dhe një mbete për evidencë.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Glllogocit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Glllogocit.
- VII. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e portokolit të MAPL dhe publikim në uebfaqën e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400-11613 dt 02.03 2015



Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 27.02.2015 miratoi këtë:

VENDIM
PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2014 në vitin 2015. Mjetet për bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2.

Të hyrat vetanake të alokuara dhe të pa shpenzuara që duhet të bartën janë në shumë prej: 230,373.90€.

Neni 3.

Shumë e mjeteve për bartje nga neni 2. i këtij Vendimi do të shpenzohet në këto kategori të shpenzimeve dhe në këto programe - nënprograme të komunës:

PAGA DHE MËDITJE:

-Drejtoria për shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale në nënprogramin e Kujdesit
Primar Shëndetësor shuma prej:.....15,505.00€
-Drejtoria për Arsim në nënprogramin Arsimit i Mesëm shuma prej:.....7,445.20€
Gjithsej paga dhe mëditje:.....22,950.20€.

MALLRA DHE SHËRBIME:

- Zyra e Kryetarit shuma prej:..... 1,115.65€
-Drejtoria për Administratë dhe Personel shuma prej:.....2,045.14€
-Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport shuma prej:.....11,732.56€
-Qendra për Punë Sociale shuma prej:.....722.51€
-Drejtoria për Arsim në nënprogramin Arsimit i Mesëm shuma prej:..... 2,554.03€
-Administrata e Arsimit shuma prej:..... 22,554.03€
-Arsimi parafillor fillor shuma prej:.....10,530.59€
-Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë shuma prej:..... 10,000.00€
Gjithsej mallra dhe shërbime.....61,096.57€.

SH.SH Komunale:

-Drejtoria për Administratë dhe Personel shuma prej:..... 531.86 €

SUBVENCIONE-TRANSFERE:

- Drejtorati për Bujqësi ,Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik shuma prej:.....11,909.78 €
-Drejtorati i Shëndetësisë -Administrata në shumë prej:..... 253.43 €,
-Drejtorati Për Kulturë Rini dhe Sport shuma prej:.....657.97 €
Gjithsej subvencione-transfere.....12,821.18 €.

SHPENZIMET KAPITALE:

-Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit me bartjen e mjeteve do të financoi këto projekte kapitale sipas këtyre shumave:

1.Asfaltimi i rrugës në Shtuticë lagja Balijs ,Mala dhe Sylaj shuma
prej..... 80,000.00 €
2.Asfaltimi i rruigës Kizha Rekë në shumë prej:.....27,801.53 €
dhe
3.Bashkë Financimi i Projekteve në shumë prej:.....24,271.68€
Gjithsej shpenzime kapitale:.....132,073.21€.

PARTICIPIMI PËR INVESTIME:

Drejtorati për Bujqësi ,Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik shuma prej:.....900.88 €
Gjithsej participimi.....900.88€.

Neni 4.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit,dhe për zbatimin e tij do të kujdesen;Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa,Drejtorati për Administratë dhe Personel, Drejtorati për Arsim, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, si dhe Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

Nr. ~~400~~ - 11611 dt 02.03 2015



Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur më datën 27.02.2015 miratoi këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RITJËS SË TË HYRAVE VETANAKE
PËR VITIN 2014

Neni 1.

Me këtë vendim aprohet, rritja e të hyrave vetanake për vitin 2014.

Neni 2.

Rritja e të hyrave vetanake për vitin 2014 aprohet në shumë prej: 180,165.22€ dhe kjo shumë e mjeteve do të bartët për shpenzim në vitin 2015.

Neni 3.

Shuma e rritjes së të hyrave vetanake të përmendur në nenin 2 të këtij Vendimi është realizuar më shumë së planifikimi i të hyrave vetanake:

- në Sektorin e Administratës shuma prej:.....176,385.22€ dhe
- në Sektorin e Arsimit (Arsimi i Mësem) në shumë prej:.....3,780.00€.

Neni 4.

Mjetët e rritura, të realizuara dhe të aprovuara nga Kuvendi i Komunës për vitin 2014 do të shpenzohen sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve në programe dhe nënprograme buxhetore si vijon:

PAGA DHE MËDITJE:

-Zyra e Kryetarit, shuma prej:.....	223.65€
-Drejtoria për Administratë dhe Personel, shuma prej:.....	2,439.68€
-Drejtoria për Inspektion, shuma prej:.....	559.13€
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa, shuma prej:.....	1,341.90€
-Drejtoria për Shërbime Publike, shuma prej:.....	447.30€
-Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Ekonomik, shuma prej:.....	670.95€
-Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, shuma prej:.....	894.60€
-Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit shuma prej:.....	670.95€
-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shuma prej:.....	894.60€
-Drejtoria për Arsim, Administrata shuma prej:.....	559.13€
-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale. Administrata shuma prej:.....	223.65€
Gjithsej, Paga dhe Mëditje:(jubileu).....	8,925.53€

-Drejtoria për Shërbime Publike, shuma prej:.....	12,456.00€
-Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Ekonomik, shuma prej:.....	3,100.00€
Gjithsej, Paga dhe Mëditje:(ndryshim koficenti).....	15,556.00€

Gjithsej, Paga -Mëditje:(rritja e masës buxhetore për 5 vende pune).....25,343.00€

-Drejtatori për Arsim – Arsimi i mësem shuma prej:.....2,268.00€

Gjithsej, Paga dhe Mëditje:(arsimi profesional).....2,268.00€

Drejtatori për Arsim – Arsimi fillor shuma prej:.....7,060.69€

Gjithsej, Paga dhe Mëditje:(arsimi fillor).....7,060.69€

MALLRA DHE SHËRBIME:

-Drejtatori për Arsim – Arsimi i mësem shuma prej:.....1,512.00€

Gjithsej, Mallra dhe shërbime:(arsimi profesional).....1,512.00€

SHPENZIME PËR INVESTIME KAPITALE:

Drejtatori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit do të financoi këto projekte kapitale me rritje dhe bartje të hyrave vetanake:

-Asfaltimi rrugës Likoshan në shumë prej:.....100,000.00€

-Rregullimi i rrethojës së oborrit në SHFMU "Mehmet Gradica" në Gradicë në shumë prej:.....10,000.00€

-Kanalizimi në Terstenik II. në shumë prej:.....9,500.00€

Gjithsej shpenzime kapitale.....119,500.00€

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, dhe për aplikimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës, Drejtatori për Buxhet dhe Financa dhe të gjitha programet tjera buxhetore që përfitojnë nga ky vendim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj

